

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mesazhi i ministres - Sot viti i ri shkollor! Mbi 340 mijë nxënës në të gjithë vendin, 25 mijë prej tyre ulen p ër herë të parë në banka
ADRESA	https://www.syri.net/sociale/916453/sot-viti-i-ri-shkollor-mbi-340-mije-nxenes-ne-te-gji the-vendin-25-mije-prej-tyre-ulen-per-here-te-pare-ne-banka/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 06:11:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 06:01:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	354cb1c0b4594ebded9e231a427bbd7da0630f396c04263a6ca87998e995f394
TEKSTI	dd42bc80100f3a32e4d4879d37c7127797cd588a3b4464466831f3d0e12142fe
PAMJA	8d5681c34cf991acc2bf44b2714a7bc03c1dc1879ccf01ea50d765aa4e5aebf0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8fd23e3897d223a13d9733a09119bae3f20f73741344ea3134f9084af2704add
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	ff9d91b584b7f6ad6fe6fe6255283fcbda7dbe303bf00ea6d85b435b755931683
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/8fd23e3897d223a13d9733a09119bae3f20f73741344ea3134f9084af2704add

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**IRENA BEQIRAJ**Fashizmi nuk duhet kërkuar
tek revolta e protestuesve por
në Kuvend!**AGIM XHAFKA**

Dialog me mbesën



më të lexuarat

SYRI TV/ Pas ngujimit në zyra, Bankers
tërhiqet, banorët arrijnë marrëveshje me
firmënHoroskopi, 13 shtator/ Zbulo çfarë
parashikojnë yjet për secilën shenjëParashikimin e motit për sot -
Temperaturat ulen deri në 29 gradëShqipëria po përballlet me çmime
ushqimore më të shtrenjta se mesatarja
europiane! TVSH-ja, ndër më të lartat në
BEBrenda kolapsit të agjencisë së
surrogacisë që u kushtoi grave surrogate
dhe prindërve të ardhshëm ëndrrat e
paratë e tyreVIDEO/ Elbasan, tension në Këshillin
Bashkiak, opozita: Fondi i emergjencave
nuk po përdoret nga mungesa e
planifikimit

Sot viti i ri shkollor! Mbi 340 mijë nxënës në të gjithë vendin, 25 mijë prej tyre ulen për herë të parë në banka

08:01, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

**Mbi 340 mijë nxënës do të ulen në bankat e shkollës, me rreth 25 mijë
nxënës ulen sot për herë të parë në bamlat e shkollës, ndërsa këtë të hënë,
14 shtator nis viti i ri shkollor 2026-2027.**Në ditën e parë të vitit të ri shkollor Ministria e Arsimit Mirela Kumbaro, u është
drejtuar me një videomesazh të gjithë nxënësve në arsimin parauniversitar, duke
u uruar suksese dhe një vit të mbarë shkollor.Përmirësimi i infrastrukturës, rritja e masave të sigurisë dhe zgjerimi i aktiviteteve
pas shkolle, shënojnë nisjen e vitit të ri shkollor 2026-2027.Përmes një mesazhi urimi drejtuar nxënësve, mësuesve dhe prindërve, Ministria e
Arsimit, Mirela Kumbaro, nënvizoi punën e Ministrisë së Arsimit dhe institucioneve
arsimore për sigurimin e kushteve më të mira të mësimdhënies dhe për krijimin e
mjedisit të ngrohtë e nxitës në shkollë, veçanërisht për rreth 25 mijë fëmijët që
ulen për herë të parë në bankat e shkollës.**Mesazhi i Ministres Mirela Kumbaro:**

"Mirëmëngjes, këtë ditë të parë të shkollës të gjithë ju nxënës të
dashur, mësues, prindër dhe gjyshër që sot shoqëroni nipër e mbesa
në shkollë. Të dashur vogëlushë që sot nisni klasën e parë, që në
fytyrë shfaqni buzëqeshje, por brenda jush keni shumë emocione dhe
zemrat e vogla ju rrahin fort, kjo do të jetë një ditë që do ta mbani
mend gjatë, ndoshta gjatë gjithë jetës suaj, prandaj ne të rriturit,
mësuesit, drejtorit i shkollës suaj, jemi kujdesur që kjo të jetë një ditë e
bukur, e gëzueshme dhe ju të ruani kujtime të bukura prej saj.
Ju sot do të njihni shkollën tuaj, do të mësoni ku do të jetë klasa juaj,
do të mësoni ku është palestra ku do të luani, oborri ku do të pushoni,
laboratori inteligjent i shkollës ku do të mësoni të bëni gjëra të bukura,
do të mësoni emrat e shokëve dhe shoqeve tuaj. Ne sot jemi së
bashku dhe do të jemi së bashku këtu e do ditë të vitit shkollor

Ashtu siç do të jemi edhe me shokët tuaj më të rritur në klasë të dytë, të tretë e me radhë. Që kanë më shumë libra dhe i kanë detyrat pak më të vështira se sa ju. Suksese të dashur nxënës të gjithë arsimit parauniversitar nga parashkollori deri në maturë. Ne do të punojmë çdo ditë këtë vit që ju të keni kushte sa më të mira ku mësoni, laboratore, smartlabe dhe projekte ku ju mund të mësoni e shkëlqeni siç është festivali i shkencës, siç janë olimpiadat, siç është konkursi i gjuhës, apo konkursi i zërave të bardhë nëpër kore. Dhe mos u mërzisni nëse mësuesja ju kërkon të fusni celularin në kuti para se të futeni në mësim. Mos e quani një urdhër – ndalim. Është shumë e rëndësishme që e gjithë vëmendja dhe fokusi juaj të jetë në mësim. Suksesi dhe profesioni që do të keni nesër varet nga sa do të mësoni SOT! – veçanërisht ju maturantë të dashur që keni një vit plot sfida përpara dhe vetëm të mësuarit do të mund t'ju nxjerrë faqebardhë! Paçi një vit plot arritje në mësim dhe plot kreativitet gjatë programit pas shkolle, 408 shkolla do të jenë në këtë program për të krijuar edhe aktivitete të tjera, ku nxënësit mund të rrinë edhe pak më gjatë në shkollë, jo vetëm për të mësuar por edhe për t'u zbavitur. Suksese!”

Ky vit shkollor sjell edhe një sërë zhvillimesh të rëndësishme për nxënësit, mësuesit dhe familjet.

53 shkolla të reja ose të rehabilituara hapin dyert këtë vit shkollor, ndërsa më herët Ministria e Arsimit Mirela Kumbaro ka bërë të ditur se janë miratuar edhe 39 projekte të tjera për rikonstruksionin e shkollave.

Me fokusin për sigurinë në shkolla, këtë vit do të jenë në shërbim të nxënësve mbi 400 oficerë sigurie, të cilët do të punojnë sipas protokolleve dhe standardeve të përditësuara. Paralelisht, është fuqizuar edhe shërbimi psiko-social, me 900 psikologë dhe punonjës socialë që do të jenë të pranishëm në shkollat e vendit gjatë vitit shkollor 2026–2027, për t'iu përgjigjur nevojave sociale dhe emocionale të nxënësve. 20 shkolla të Tiranës janë pjesë e projektit pilot “Smart City”, me kushte të shtuara sigurie përmes kamerave inteligjente.

Një prej risive të këtij viti është programi “Pas Shkolle”, i cili pas fazës pilot në Tiranë gjatë vitit të kaluar, shtrihet tashmë në 408 shkolla në të gjithë Shqipërinë. Në javët e para të vitit shkollor, nxënësit dhe prindërit do të informohen mbi funksionimin e programit dhe do të kenë mundësinë të zgjedhin klubet ku dëshirojnë të marrin pjesë, nga arti e muzika te teatri, sporti, zëjet dhe aktivitete të tjera. Për organizimin e tyre, aktualisht është e hapur edhe thirrja për trajnerët, ku mund të aplikojnë mësues, mësues në pension, artistë, artizanë dhe profesionistë të fushave përkatëse.

Ndërkohë, nga të dhënat paraprake nga Ministria e Arsimit për këtë vit shkollor, janë rreth 1200 nxënës që janë transferuar nga shkollat jo-publike në shkollat publike, një prije që tregon besimin në rritje të familjeve te cilësia dhe mundësitë që ofron sistemi publik i arsimit.

© SYRI.net

Lexo edhe:



SYRI TV/ Përmblytje nga shiu i rrëmbyer në Elbasan, banorët kërkojnë ndihmë emergjente



Shqipëria po përballlet me çmime ushqimore më të shtrenjta se mesatarja europiane! TVSH-ja, ndër më të lartat në BE



Këshillat e ekspertëve: 5 gjëra që nuk duhet t'i ndani me ChatGPT

TË NGJASHME



Sot priten reshje shiu në të gjithë territorin, njihuni me parashikimin e motit dhe sa do të jenë temperaturat

Parashikimi i horoskopit 12 shtator, ja çfarë kanë rezervuar yjet për ju sot

PISA 2025/ Si u deformuan të dhënat nga qeveria, reagon OECD: Nuk i miratua ndryshimet

Horoskopi, 13 shtator/ Zbulo çfarë parashikojnë yjet për secilën shenjë

Shiu përmyt Elbasanin, shikoni si makinat notojnë në ujë në 2 lagje të qytetit

Pak minuta shi përmytin 6 banesa në zonën 41 të Elbasanit

Elbasan/ Çahet asfalti në afërsi të urës së lumit Shkumbin, ndërpritet përkohësisht qarkullimi

Vetëm 30 minuta shi, përmyten rrugët kryesore të Elbasanit

Fluks i shtuar në kufirin Shqipëri-Kosovë, mijëra qytetarë udhëtojnë për protestat

A jemi të gjithë paksa narcistë?

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MUEJIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.